VENDIM
Nr. 461, datë 10.6.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 661, DATË 7.8.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJAVE 110 kV DHE 220 kV QË LIDHIN KASKADËN E DEVOLLIT ME SISTEMIN E TRANSMETIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 661, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 3, shifra "3 610 343.8 (tre milionë e gjashtëqind e dhjetë mijë e treqind e dyzet e tre pikë tetë) lekë" ndryshon dhe bëhet "3 908 239.5 (tre milionë e nëntëqind e tetë mijë e dyqind e tridhjetë e nëntë pikë pesë) lekë".

b) Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

"4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 908 239.5 (tre milionë e nëntëqind e tetë mijë e dyqind e tridhjetë e nëntë pikë pesë) lekësh, të përballohet nga shoqëria "Devoll Hydropower", sh.a.".

c) Tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet tabela bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, zyra vendore Gramsh dhe shoqëria "Devoll Hydropower", sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Qarku/ Elbasan/ Fshati	Nr. Rendor	Nr. i shtyllave	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sasia e sip. së pronës m^2	Sipërfaqe shpronësimi definitiv m^2	Çmimi i tokës lekë /m^2	Vlera e kompensimit
Fshati Malasej	1	30	Qani	Hasan	Kabashi	arë	2559	121/4	3000	74.0	222	16428.0
	2	31	Shpetim	Mehdi	Hoxha	arë	2559	113/22	1400	6.0	222	1332.0
	3	32	B/P Hoxha			Arë	2559	arë	2800	4.0	222	888.0
	4	33	Bashkim	Sali	Kamami	arë	2559	24/7	5750	8.0	222	1776.0
Fshati Shtërmen	1	23	Robert	Venemin	Xhania	arë	3422	224/75	2000	13.0	222	2886.0
	2	25	Agron	Jorgji	Mema	arë	3422	237/24	3600	7.0	222	1554.0
	3	22	Todi	Pali	Doka	arë	3422	291/4	2750	72.0	222	15984.0
Fshati Cërrik 2	1	42	Xhevahire	Qemal	Rusi	arë	2281	263/3	3750	37.0	263	9731.0
	2	41	Asije	Shane	Isaj	arë	2281	285/8	3750	28.4	263	7469.2
	3	40	Besnike	Sali	Carciu	arë	2281	288/7	4500	25.0	263	6575.0
	4	36	Naxhije	Hysen	Cekrezi	arë	2281	295/6	1500	10.0	263	2630.0
	5	36	Koze	Ymer	Cekrezi	arë	2281	295/7	3000	19.0	263	4997.0
	6	35	Shaban	Ramazan	Nasufi	arë	2281	296/6	6000	29.0	263	7627.0
	7	34	Altin Rozeta	Riza Bajram	Rabushja Rabushja	arë	2281	297/24	2500	44.5	263	11703.5
	8	37	Suzana	Demir	Mustafaj	arë	2281	301/22	2250	25.0	263	6575.0
LISTA E PRONARËVE PËR SHPRONËSIM PËR EFEKT TË NDËRTIMIT							**LINJËS 220 kV**					
Gramsh-Fshat	1	50	Avni	Zylal	Mema	arë	1844	5/5	3,000	140.00	174.00	24360.0
Fshati Kryezjarth	1	104	Gazmend Merkur Kuri	Kuri Spiro Spiro	Doka Doka Doka	arë	2296	34/8	1,350	51.00	222.00	11322.0
	2	104	Merkur	Simon	Drizari	arë	2297	33/3	10,140	107.00	222.00	23754.0
Fshati Mjekes	1	107	Nevruz	Sadik	Xhika	arë	2703	151/1	1400	148	222.00	32856.0
LISTA E PRONARËVE PËR SHPRONËSIM PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË NËNSTACIONIT ELBASAN												0.0
Bashkia Elbasan	1		Shefik Zyliha Astrit	Tafil Haxhi Feri	Demoreti Demoreti Keco	Are	8526	430/14	2000	484	222.00	107448.0
Shuma totale												**297895.7**